



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA JURIDIKE**

20564
Nr. _____ Prot

Shkodër, më 29.12.2023

VENDIM

Nr. 513, datë 29.12.2023

“PËR DELEGIM KOMPETENCE”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; ligjit nr.44/2015 “Kodi Procedurave Administrative Republikës së Shqipërisë”; ligjit nr.9936 ,datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; ligjit Nr.10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; ligjit nr.9920 dt.19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, te ndryshuar; ligjit 9632 date 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar; ligjit nr.9270 date 29.07.2004 “Për sistemin e adresave” të ndryshuar; ligjit nr.8308 date 18.03.1998 “Për transportet rrugore” të ndryshuar; ligjit nr.93/2015 “Për Turizmin” të ndryshuar; Udhezimi nr.30/2011 “Për menaxhimin e aktiveve ne njesite e sektorit publik” të ndryshuar;

VENDOSA:

1. Delegimin e kompetencave të Kryetarit të bashkisë Shkodër, z.Rudin Beka me detyrë zëvendeskryetar i bashkisë Shkodër;
 - Për nënshkrimin e çdo shkrese që ka të bëjë me institucionet publike, personat juridik/ fizik dhe individ për;
 - Drejtorinë e të Ardhurave
 - Drejtorinë Turizmit
 - ZIN
 - Saktësime Adresash
 - Lejet e transportit
 - Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse
2. Zv/kryetari nuk mund t'i nëndelegojë këto kompetenca zyrtarëve të tjerë.

3. Kompetencat e deleguara do të ushtrohen duke filluar nga data 03.01.2024 dhe përfundon me datë 28.06.2024.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet z.Rudin Beka dhe administrata bashkisë Shkodër.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen WEB të bashkisë Shkodër.

KRYETAR

Benet BECI

